



Në pajtim me kompetencat, përgjegjësitë, kornizën ligjore dhe rregulatore në fuqi (Ligji Nr. 03/L-086, të datës 13 qershor 2008, Mbi Ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2004/49, për Veprimtaritë e Shërbimeve të Ujësjetësve, Kanalizimeve dhe të Mbeturinave, neni 38.1. dhe të Rregullës R-02/UeK, të datës 12.08.2008, Për Përcaktim të Tarifave të Shërbimit për Shërbimet e Ujësjetës, Ujërave të zeza, dhe të Furnizimit të Ujit me Shumicë në Kosovë, Kapitulli 5. Aplikimi, Shqyrtimi dhe Aprovimi i tarifave të Shërbimit, neni 15.1 dhe 15.2. dhe Politikave tarifore për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizim të dhjetorit 2007, pika 3.5 Mbulimi i kostove dhe pika 4.2. Rishikimi i përkohshëm periodik i tarifave), Zyra Rregulatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) ka rishikuar tarifat e shërbimit të përcaktuara me 31 dhjetor 2011 për KRU-t për vitin 2011 nga periudha rregulatore 2009-2011.

Duke u bazuar në procesin e monitorimit të efekteve të tarifave të shërbimit të përcaktuara me procesin tarifar 2009-2011, për vitin 2010 dhe rrethanave të përgjithshme shoqërore të afarizmit që kanë ekzistuar gjatë vitit aktual.

Zyra Rregulatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM), merr:

VENDIM

Për Konfirmimin e Tarifave të Shërbimit për vitin 2011
sipas Urdhëresave Tarifore të Shërbimit 2009-2011, të
datës 31 dhjetor 2008

- Me të cilin konfirmohen Tarifat e Shërbimit të përcaktuara me procesin tarifar për periudhën 2009-2011.
- Fillimin e aplikimit të tarifave të shërbimit të përcaktuara me procesin rregullatorë 2009-2011 edhe për vitin e mbetur tarifarë të këtij cikli rregullatorë të vitit 2011 sipas UTSh-ve të lëshuara për të gjitha KRU-t me 31 dhjetor 2008,
- Vlefshmëria e ekzistimit të tarifave të tilla është nga: **1 janari gjerë me 31 dhjetor 2011**,
- Ky vendim është i aplikueshëm për të gjitha Kompanitë Regjionale të Ujit të licencuara nga ZRRUM.

KRU-ve të cilave iu referohet ky Vendim kanë të drejtë të ankohen në këtë vendim në afat prej 15 ditësh nga data e nxjerrjes së tij në pajtim me dispozitat Ligjit për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujit dhe Mbeturinave.

KRU-të duhet të bëjnë publikimin e tarifave të tilla sipas nenit 25, pika 25.1 dhe 25.2 të Rregullës ZRRUM R-02/UeK.

Prishtinë, 31 dhjetor 2010


Raif Preteni
Drejtor i ZRRUM-it